

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr. 1908 Prot.

Kuçovë, më 06.05. 2026

V E N D I M

Nr. 31, datë 28/04 / 2026

“Për miratimin e fondit të emergjencës civile të fatkeqësisë natyrore në familjen e Znj. Dituri Saraseli të shkaktuara nga rënia e reshjeve të shiut pergjatë muajve të fundit”.

Këshilli Bashkiak, pasi u njohë me materialin e paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile, Mbështetur në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile” dhe në zbatim te V.K.M –së nr 329 dt.16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, specialistë të Sektorit të Emergjencave Civile ka konstatuar rastin si pasojë e fatkeqësisë natyrore nga reshjet intensive të shirave të periudhës së fundit ku ka mbajtur dhe një Proces Verbal Konstatimi. referuar shkresës të ardhur nga Këshilli Qarkut Berat me Nr. 293 Prot. datë 17.04.2026 protokolluar në institucionin tonë me Nr. 1558/1 Prot. datë 20.04.2026, na vunë në dispozicion preventivin mbi vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga reshjet intensive për familjen e Znj. Dituri Saraseli.

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit të emergjencës civile sipas preventivit të hartuar nga Këshilli i Qarkut Berat për familjen e Znj. Dituri Saraseli ku është vlerësuar me shumën **538,853 lekë**, në zbatim të ligjit të sipërpërmendur do të dëmshpërblehet me 50% të shumës së preventivit, ku shuma përfituese është **269,426 lekë**.

2. Ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për të ndjekur zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes

Ky vendim u miratua me 21 vota Pro, — vota kundër dhe — vota abstenim.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ALEKSANDËR ZIU


